



# BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.3

Prill 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

## Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

I. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 26.3.2004.

### PROJEKTLIGJE

Miratim vendimesh për propozim projektligjesh.

1. Për ratifikimin e marrëveshjes së konçesionit të formës "BOO", për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në gjirin e Vlorës, si dhe për miratimin e marrëveshjes së konçesionit, të formës "BOT", për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit tregtar në gjirin e Vlorës.

2. Për ratifikimin e protokollit ndryshues të kontratës europiane për shtypjen e terrorizmit.

Vendime të Këshillit të Ministrave

1. Për caktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet buxhetore, për vitin 2004.

2. Për transferimin e pronave të paluajtëshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njërive të qeverisjes vendore.

3. Për miratimin në parim të memorandumit të sesionit të katërt të komisionit të përbashkët ndërqeveritar shqiptarokinez, për bashkëpunim tregtar dhe ekonomik.

4. Për miratimin në parim të protokollit të sesionit të katërt të komisionit të përbashkët ndërqeveritar shqiptarokinez,

për bashkëpunim tregtar dhe ekonomik.

5. Për miratimin në parim të protokollit shtojcë të konventës europiane kundër dopingut në sport.

6. Për lejimin e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për vlerësimin e studimit të fizibilitetit për modernizimin e linjës hekurudhore Tiranë-Durrës dhe të lidhjes hekurudhore me aeroportin "Nënë Tereza" Rinas.

7. Për një ndryshim në vendimin nr 379, datë 31.5.2001 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e planit kombëtar të radiofrekuencave".

II. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 10.4.2004

### PROJEKTLIGJE

Miratim vendimesh për propozim projektligjesh.

1. Për ndryshim në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.

2. Për ndryshim në ligjin nr. 8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet".

*Shënim.* Këto dy projektligje kanë lidhje midis tyre. Sipas ndryshimeve që propozohen, leja për zhvillimin e lojrave në kazino i jepet organizatorit vetëm pasi ai ka paguar shumën prej 100.000.000 (njëqind milion) lekë, në vend të shumës

(Vijon në faqen 2)

## Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

faqe 1-2

2. Tryezë e rrumbullakët me ekspertë të fushës së drejtësisë

faqe 1

3. Dispozita ligjore që lidhen me pjesëmarrjen e publikut gjatë procesit legjislativ

faqe 3

4. Nga punimet e Kuvendit për periudhën 15-31 mars 2004

faqe 3-5

5. Kalendari 2 javor i Kuvendit, 13-22 prill 2004

faqe 6-7

## Tryezë e rrumbullakët me ekspertë të fushës së drejtësisë

Më datë 8 Prill 2004, në ambientet e Pallatit të Kongreseve, u zhvillua tryeza e rrumbullakët me ekspertë të fushës së drejtësisë, për diskutimin mbi projektligjin "Për masat kundër financimit të terrorizmit". Ministria e Drejtësisë ka përgatitur këtë projektligj në kuadër të angazhimeve institucionale të qeverisë për luftën kundër terrorizmit e në kuadrin e planit legjislativ 2004-2005. Kjo tryezë në fushën e hartimit të legjislacionit u organizua për përfshirjen e ekspertizës juridiko-profesionale me synimin për të thithur kontribute sa më cilësore në këtë proces dhe për të siguruar përfaqësim sa më të mirë të të gjitha grupeve të interesit. Ministria e Drejtësisë ka përcaktuar një sërë masash që synojnë ndër të tjera të përmirësojnë në mënyrë cilësore marrëdhëniet me publikun dhe veçanërisht rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes në procesin legjislativ.

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

## (Vijon nga faqja 1)

prej 30.000.000 (tridhjetë milion) lekë që ka qene parashikuar më parë.

Rritja e nivelit të kësaj takse sjell rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit.

3. Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit "Periferitë urbane të Tiranës komponentë infrastrukturor."

*Sbënim:* Ky projektligj synon përfundimin e procedurës kushtetuese ligjore të kërkuar për hyrjen në fuqi të saj. Marrëveshja është nënshkruar më 29.1.2004.

### Vendime të Këshillit të Ministrave

1. Për përparësitë, fushat dhe nivelet e bashkëpunimit të shërbimit Informativ të Shtetit me shërbimet informative të vendeve të huaja.

*Sbënim:* Me këtë vendim rregullohen probleme të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës në fushën informative me partnerët dhe synohet efikasiteti i luftës së shtetit shqiptar kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe akteve terroriste.

2. Për programin pilot të delegimit të funksionit të investimeve, për vitin 2004, për arsimin parauniversitar, bashkisë së Tiranës për territorin që kjo bashki mbulon.

3. Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "UFO Dental".

*Sbënim:* Kjo shkollë është e nivelit universitar (fakultetet) me një degë të vetme -stomatologji- dhe ka për qëllim të përgatisë e diplomojë mjekë stomatologë të përgjithshëm të një niveli të lartë.

4. Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit.

5. Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.550, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave "Për tarifat e shërbimeve që kryhen nga shërbimi i gjendjes civile".

6. Për miratimin e kontratës së menaxhimit, ndërmjet ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve të bashkive Durrës, Fier, Lezhë e Sarandë dhe shoqërive Berlin Wassser International AG e Berlin Wasser Holding AG, për sigurimin e shërbimeve të ujit dhe të kanalizimeve.

7. Për dhënien emrit "Spiro Moisiu" Akademisë së Mbrojtjes.

8. Për transferimin në pronësi të bashkisë së Bajram Currit të mjediseve të degës së mobilizimit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

9. Për transferimin në pronësi të bashkisë së Gramshit të mjediseve të ish-Shtëpisë së Ushtarakëve, të ish-shtabit të repartit ushtarak 9920 dhe të degës së mobilizimit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

10. Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të degëve të mobilizimit në qytetet Lushnjë dhe Ballsh, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

11. Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të degës së mobilizimit në qytetin e Çorovodës, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes."

12. Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes të disa ngastrave pyjore, pjesë të ekonomisë pyjore Zall-Herr-Priskë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes."

13. Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal të Zvicrës, për heqjen reciproke të detyrimeve të vizës për mbaj-

tësit e pasaportës diplomatike.

14. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë për bashkëpunim për zhvillim.

*Sbënim:* Në bazë të kësaj marrëveshjeje palët kanë rënë dakort që të krijojnë marrëdhënie partneriteti në një numër fushash për zhvillimin ekonomik-social të vendeve të tyre, sidomos për çështje mjedisore, mbështetje për arsimin dhe trajnimin profesional, biznesin dhe financat, nxitjen e investimeve produktive etj.

15. Për tërheqjen e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7650, datë 17.12.1992" "Për birësimet e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes".

16. Për dhënie ndihme financiare zonjës Thëllënxa Kupa, për lindjen e pesë-njakëve.

17. Për masën e indeksimit të pagave për vitin 2004.

*Sbënim:* Masa e indeksimit të pagave, mbështetur në informacionin vjetor të llogaritur mbi një shportë të reduktuar të mallrave, sipas metodologjisë së miratuar nga grupi i punës për studimin e ndarjes së indeksit nga rritja e pagave, është 3,4%. Vendimi e shtrin efektin financiar duke filluar nga data 1.4.2004.

18. Për një ndryshim në vendimin nr 289, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret dhe përbërjen e këshillave mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore".

*Sbënim:* Ky ndryshim mundëson përmirësimin e procedurave për emërimet dhe ndryshimet në këshillat mbikqyrës të shoqërive që veprojnë në sektorët strategjikë.

### Në këtë mbledhje u bë dhe analiza për realizimin e:

-Matricës së përgjithshme të ministrave për vitin 2004, të miratuar me vendimin nr 64, datë 29.1.2004 të këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2004".

- Matricës së detyrave parësore për vitin 2004 të hartuar në zbatim të fjalës së Kryeministrit në analizën e punës së qeverisë për vitin 2003. Matricës së ministrave për programin "Lehtësimi i qarkullimit të lirë të njerëzve" të miratuar në mbledhjen e Komitetit Ndërmintor të Politikave të Sigurisë, më datë 28.1.2003.

## Dispozita ligjore që lidhen me pjesëmarrjen e publikut në procesin legjislativ

Nga Rregullorja e Këshillit të Ministrave, miratuar me vendimin nr.584, datë 28.08.2003

q

7. Si rregull, brenda muajit dhjetor të cdo viti kalendarik dhe, në cdo rast, brenda afatit të caktuar nga Kryeministri, sipas fushës së veprimtarisë që kanë në kompetencë, ministrat i paraqesin Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave **projektprogramin e hollësishëm të projekt-akteve** që parashikojnë të propozojnë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në vitin pasardhës.

10. Pas miratimit të programit analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, sipas fushës së veprimtarisë që ka në kompetencë, ministri urdhëron miratimin e **programit të hollësishëm të masave, afateve dhe strukturave përgjegjëse për zhvillimin e procesit legjislativ në tërësi dhe për projektakt**, raportimin për ecurinë e tyre deri në përfundimin e hartimit të projektaktit dhe paraqitjen e tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

13. Mbështetur në vlerësimin paraprak të projektaktit, ministri cakton me urdhër të veçantë çështjet që duhen rregulluar, **format e pjesëmarrjes** dhe hapat kryesorë të realizimit dhe bashkërendimit të procesit legjislativ, afatet përkatëse për realizimin e tyre, strukturat përgjegjëse, si dhe burimet materiale dhe njerëzore që ngarkohen të bashkëpunojnë me strukturën juridike për hartimin e cdo projektakti.

14. Proektaktet hartohen nën përgjegjësinë e strukturës juridike, e cila në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse dhe ato të fushave përkatëse të ministrisë, **organizon këshillime me drejtues a specialistë të drejtorive, sektorëve a enteve, si dhe me struktura të shoqërisë civile**, veprimtaria e të cilëve lidhet me objektin, qëllimin dhe zbatimin e projektaktit.

50. Për projektaktet me rëndësi të veçantë, Kryeministri i vënë në dijeni nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, shqyrton propozimin në bazë të disa kriterëve lidhur me urgjencën e propozimit, **kërkesën e publikut**, plotësimin e objektivave të politikave kombëtare të zhvillimit, mundësisë së zbatimit të shpejtë etj. **Këto projektakte mund të diskutohen në rrethe të gjera, ku mund të përfshihen përfaqësues të institucioneve shtetërore, OJF-ve, ekspertë të institucioneve apo organizatave ndërkombëtare, etj.**

66. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave merr masa për:

- a) zbardhjen e të gjitha akteve të Këshillit të Ministrave;
- b) rregullimin e akteve të miratuara me ndryshime;
- c) nënshkrimin e akteve
- ç) shpërndarjen e tyre në institucionet që kanë detyrime apo lidhje me përmbajtjen e aktit.

67. Sekretari i Përgjithshëm merr masat për **botimin e të gjitha akteve normative të Këshillit të Ministrave në Fletoren Zyrtare brenda afateve ligjore**, si dhe në organe të tjera botuese, brenda një kohe sa më të shkurtër.

68. Shpërndarja zyrtare e akteve bëhet nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm jo më vonë se dy ditë pas nënshkrimit të tyre.

## NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-15 PRILL 2004

### I- PROJEKTLIGJE TË SHQYRTUARA NË KOMISIONET E PËRHERSHME TË KUVENDIT DHE NË SEANCË PLENARE

**1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”** (miratuar në seancë plenare më datë 8 prill 2004)

Ky projektligj ka si objekt korrigjimin e disa mangësive, që kanë dalë gjatë zbatimit të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”. Ndryshimet e propozuara në të konsistojnë në forcimin e rregullave për kryerjen e veprimtarisë në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, për parandalimin e rreziqeve që mund t'i shkaktohen njerëzve dhe mjedisit nga shkelja e rregullave të sigurimit teknik.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare deputetët debatuan dhe ndryshuan formulimin e disa neneve të projektligjit, të cilat sipas tyre, synojnë rritjen e përgjegjësisë së organeve shtetërore për zbatimin e kërkesave të këtij ligji. Ndryshimet kryesore u bënë në këto nene:

- Me këtë projektligj i jepet e drejta ministrisë që është përgjegjëse për veprimtarinë në fushën e hidrokarbureve të licensojë specialistët që punojnë në subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe në fushën e kërkimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Disa deputetë e mbështetën këtë propozim të projektligjit, ndërsa disa të tjerë u shprehën kundër, pasi sipas tyre, me këtë nen i jepet e drejta e licensimit jo vetëm specialistëve që krijojnë një subjekt juridik në fushën e kërkimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit, por edhe specialistëve që punojnë në subjekte të tilla. Dhënia e së drejtës së licensimit të gjithë specialistëve që punojnë në këto subjekte është shumë e gjerë dhe e parakohshme, theksuan ata. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi heqjen e këtij neni.

- Sipas ligjit ekzistues, rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë janë të detyruara të mbajnë rezerva sigurie për mbulimin e nevojave të konsumit kombëtar në periudha krize dhe situatash të jashtëzakonshme. Në projektligj propozohet të bëhet një shtesë, e cila vë para një detyrimi të tillë edhe instalimet bregdetare, që kanë objekt veprimtarie naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre. Duke qenë se instalimet bregdetare janë shoqëri anonime dhe në ligjin ekzistues parashikohen si subjekte që i nënshtrohen këtij ligji, deputetët e quajtën të

*(Vijon në faqen 4)*



# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 15-31 MARS 2004

*(Vijon nga faqja 3)*

panevojshme këtë shtesë në projektligj dhe Kuvendi miratoi heqjen e saj.

- Deputetët debatuan lidhur me nenin e projektligjit, që i jep të drejtën e licencimit impianteve të përpunimit të nënprodukteve të naftës. Disa deputetë shprehën mendimin se kërkesa për t'i licencuar këto subjekte është e tepërt, pasi ato nuk kryejnë ndonjë veprimtari me rrezikshmëri të lartë apo veprimtari strategjike. Aq më tepër, theksuan ata, kjo kërkesë i kontribuon centralizimit të tepëruar të kompetencave dhe monopolizimit, si dhe vështirëson procedurat. Në përfundim të diskutimit, deputetët nuk e ndryshuan këtë nen të projektligjit, pasi duke mbështetur mendimin e specialistëve që e kanë përgatitur atë, ky nen i forcon masat administrative dhe është në përputhje me legjislacionin europian.

- Kuvendi nuk miratoi nenin e projektligjit, i cili e kalon kompetencën e miratimit të normave teknike për impiantet e depozitimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre nga ministria tek Këshilli i Ministrave, me argumentin që të mos largohet përgjegjësia për hartimin dhe zbatimin e këtyre normave nga punonjësit e ministrisë dhe të inspektoratit përkatës të krijuar prej saj.

- Një çështje tjetër që u diskutua ka të bëjë me propozimin e disa deputetëve për të vendosur me ligj një kufizim lidhur me distancën e ndërtimit të stacioneve të shitjes së karburanteve, me qëllim ruajtjen e mjedisit. Disa deputetë propozuan që ky kufizim të mos vendoset në ligj, por të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në përfundim, deputetët nuk e miratuan vendosjen e një kufizimi të tillë, me argumentin që ai dëmton konkurrencën e lirë.

- Kuvendi miratoi shtesën e një neni, i cili detyron Inspektoratin Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre që të ushtrojë kontroll për cilësinë e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre si për sasi të importuara, ashtu edhe për sasi të prodhuara në vend.

**2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, ndryshuar me ligjin nr.8790, datë 10.5.2001 (miratuar në seancë plenare më datë 1 prill 2004)**

Projektligji synon plotësimin e disa mangësive që janë vërejtur nga zbatimi i ligjit ekzistues, duke bërë disa shtesa e ndryshime në të, të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e profesionit të noterit, procedurën që duhet të ndjekë Dhoma Kombëtare e Noterëve dhe Ministria e Drejtësisë për plotësimin e vendeve vakante për ushtrimin e veprimtarisë së noterit, procedurat për përfitimin e profesionit të noterit, procedurat për transferimin e noterit, si dhe rregullon dispozitat që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit të noterit.

Gjatë diskutimit të këtij projektligji në Komisionin e Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore u shfrytëzua përvoja e ekspertëve të Këshillit të Europës, si dhe u tërhoqën mendimet e përfaqësuesve të Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe specialistëve të Ministrisë së Drejtësisë. Mbi bazën e vërejtjeve të tyre, ky Komision hartoi një projektligj të ri, më të plotë se projektligji i paraqitur nga Këshilli i Ministrave, i cili u votua dhe u miratua në seancë plenare. Gjatë diskutimit të projektligjit në seancë plenare Kuvendi miratoi disa propozime të deputetëve për ndryshimin e disa neneve të projektligjit. Konkretisht, u miratua propozimi për ndryshimin e përbërjes së Komisionit të Kualifikimit për Noterinë, duke zëvendësuar nga ky Komision gjyqtarin e Gjykatës së lartë dhe gjyqtarin e Gjykatës së Apelit me specialistë të Ministrisë së Drejtësisë, për të shmangur konfliktin e interesave që mund të krijohet në rastet kur një gjyqtar ka shqyrtuar një çështje gjyqësore që lidhet me kandidatin konkurrues për ushtrimin e profesionit të noterit. Gjithashtu, Kuvendi miratoi disa ndryshime në nenin që bën fjalë për rastet e heqjes së të drejtës për të ushtruar profesionin e noterit.

**3. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8576, datë 3.2.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë” (miratuar në seancë plenare më 8 prill 2004)**

Projektligji synon përmirësimin e disa dispozitave të ligjit ekzistues, me qëllim shmangjen e disa mangësive në drejtim të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Bibliotekave për të rritur profesionalizmin e tij, përmirësimin e mbikëqyrjes së veprimtarisë së sistemit bibliotekar në vendin tonë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, përmirësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me të drejtën për shërbim dhe informacion bibliotekar, mënyrën e administrimit të të ardhurave, formimin dhe kualifikimin profesional të punonjësve të bibliotekave të vendit etj. Në projektligj propozohet që kompetenca për kategorizimin e bibliotekave publike, që ndodhen në varësi të pushtetit vendor t'i kalojë Këshillit të Ministrave.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit Kuvendi e miratoi atë, duke bërë disa ndryshime jothelbësore në disa nene të tij.

**4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8366, datë 2.7.1998 “Për shërbimin gjeologjik shqiptar” (miratuar në seancë plenare më datë 15 prill 2004)**

Projektligji synon të krijojë hapësirat e nevojshme për rritjen e frytshmërisë së punës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, duke përcaktuar më qartë objektin e veprimtarisë së tij dhe duke propozuar disa plotësime në nenet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e këtij institucioni.

*(Vijon në faqen 5)*

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 15-31 MARS 2004

*(Vijon nga faqja 4)*

Një nga çështjet që u debatua gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit kishte të bënte me nenin e projektligjit, që i jep të drejtë Këshillit Kombëtar të Ujit të ngarkojë Shërbimin Gjeologjik Shqiptar për të administruar ujërat nëntokësore. Disa deputetë shprehën mendimin se kompetencën e administrimit të të gjitha burimeve ujore, sipas ligjit "Për rezervat Ujore", e ka Këshilli Kombëtar i Ujit dhe kjo kompetencë nuk mund t'i jepet me ligj të veçantë një institucioni tjetër. Në përfundim të këtij diskutimi, deputetët nuk ranë dakord me këtë vërejtje, duke mbështetur propozimin e projektligjit për këtë çështje, i cili sipas tyre, nuk shmang kompetencën e KKU-së në fushën e administrimit të ujërave nëntokësore, por ngarkon me këtë administrim edhe SHGJSH-në, si institucioni që studion anën shkencore dhe vlerëson e monitoron këto ujëra. Sipas tyre, ky përcaktim shmang mjaft çrregullime që janë vënë re në administrimin e ujërave nëntokësore, duke e vendosur atë nën përgjegjësinë e institucionit, që kryen studimin.

Një çështje tjetër, për të cilën u debatua në Komisionin e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit ka të bëjë me nenin e projektligjit, i cili i jep të drejtë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar të përdorë, me autorizim të ministrit, një pjesë të të ardhurave që siguron nga veprimtaria me të tretët për shpërblimin e personelit të këtij Shërbimi. Gjatë diskutimit deputetët shprehën mendimin se përcaktimi i shpërblimeve nga të ardhurat e institucioneve buxhetore në ligje të veçanta mund të ndikojë në prishjen e strukturës së tyre në raportet ndërmjet institucioneve. Prandaj, ata ritheksuan edhe një herë domosdoshmërinë e unifikimit të pagave e shpërblimeve në të gjitha institucionet buxhetore.

Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin pa ndryshime.

## II. RAPORTE TË INSTITUCIONEVE TË PAVARUARA

### 1. Raporti i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë mbi veprimtarinë e këtij institucioni për vitin 2003 (mbajtur në seancë plenare më datë 5 prill 2004)

Në fjalën e tij Guvernatori i Bankës së Shqipërisë pasqyrooi një tablo të ecurisë së treguesve monetarë e financiarë të vendit gjatë vitit 2003, duke vënë në dukje përmirësimin e ekuilibrave makroekonomikë. Ai theksoi se gjatë këtij viti, në krahasim me vitin 2002, ritmet e rritjes ekonomike kanë të kënaqshme. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka patur karakter zbutës, ajo ka synuar uljen e kostos së huamarrjes dhe është diktuar nga ecuria sipas

parashikimit e inflacionit, si dhe nevoja për të ruajtur stabilitetin financiar të vendit. Treguesit monetarë janë realizuar sipas parashikimit të programit monetar të Bankës së Shqipërisë.

Gjatë debatit të zhvilluar në seancë plenare për raportin e paraqitur nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, deputetët e maxhorancës e mbështetën atë. Deputetët e opozitës u shprehën kundër politikës monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë, e cila sipas tyre, ka shkaktuar vlerësimin fiktiv të lekut, duke sjellë për pasojë jo vetëm zhvlerësimin e depozitave në valutë, por edhe rënien e eksporteve dhe shkatërrimin e konkurrencës së prodhimit vendas, duke i hapur rrugën importeve. Gjatë diskutimit u shpreh mendimi që Banka e Shqipërisë duhet të heqë dorë nga ndërhyrjet e saj në tregun bankar në blerjen dhe shitjen e valutës dhe të krijohet për këtë Bordi i Kartmonedhës.

### 2. Raporti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për veprimtarinë e këtij institucioni gjatë vitit 2003 (mbajtur në seancë plenare më datë 1 prill 2004)

Në Raportin e tij Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zoti Ilirian Celibashi, pasqyrooi veprimtarinë e institucionit që ai drejton gjatë vitit 2003, duke u përqëndruar në punën e bërë për përgatitjen, mbikëqyrjen dhe përfitimin e rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të 12 tetorit të vitit 2003. Ai pasqyrooi punën e këtij institucioni për përgatitjen e listës së zgjedhësve. Më tej, zoti Celibashi informoi Kuvendin për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Zonale të Qendrave të Votimit dhe Komisioneve të Qendrave të Votimit, dokumentacionin dhe aktet zgjedhore mbi të cilat janë mbështetur, logjistikën zgjedhore, financimin e zgjedhjeve, strategjinë e marrëdhënieve të këtij institucioni me publikun dhe shqyrtimin e ankimeve dhe apelimeve. Në përfundim, ai përmendi detyrat kryesore të institucionit që ai drejton për vitin 2004, gjatë të cilit do të fillojnë përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme në Kuvend.

Gjatë debatit deputetët e maxhorancës u shprehën dakord me Raportin e paraqitur nga Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e mbështetën atë. Deputetët e opozitës u shprehën kundër Raportit, duke e konsideruar atë të cunguar, manipulativ dhe abuziv. Ata vunë theksin në shkeljet ligjore dhe veprimet abuzive të përfqësuesve të koalicionit të majtë në këtë Komision, veçanërisht në manipulimin e listave të zgjedhësve, duke përjashtuar një pjesë të votuesve nga këto lista, keqadministrimin e kutive të votimit, si dhe ndërhyrjet e vullnetshme dhe të paligjshme në hartimin dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve.

# KALENDAR I

## 2 JAVOR (13 - 22 PRILL 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

*E Martë, datë 13.04.2004, ora 18.00*

**-Seancë Plenare -**

1. Miratimi i Kalendarit 2 javor të punimeve të Kuvendit.
2. Përgjigje e pyetjeve të deputetëve Valentin Palaj, Muhamet Ukperaj, Ligoraj Karamelo, Nikollë Lesi dhe Ardit Kaja, nga Ministri i Transporteve dhe Telekomunikacioneve.
3. Interpelancë me Ministrin e Industrisë dhe Energjitikës, kërkuar nga deputeti Besnik Mustafaj.
4. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Nikollë Lesi nga Ministri i Industrisë dhe Energjitikës.

*E Mërkurë, datë 14.04.2004, ora 10.00*

Punë në komisione:

1. Diskutimi dhe shqyrtimi i konkluzioneve të Raportit të Komisionit Europian të vitit 2004 mbi procesin e Stabilizim Asocimit.

**-Të gjitha komisionet**

2. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe udhëtarëve".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Jashtëm (e ka shqyrtuar)**

**-Komisioni i Industrisë**

3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin "Infrastruktura Ujore, Bashkiake".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Jashtëm (e ka shqyrtuar)**

**-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

**-Komisioni i Industrisë**

4. Dekret nr. 4181, datë 23.03.2004 "Kthimi për shqyrtim edhe njëherë në Kuvend të ligjit nr. 9198, datë 26.02.2004 "Për një shoqëri gjinore të barabartë".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Punës dhe**

**Çështjeve Sociale**

**-Komisioni i të Drejtave të Njeriut**

5. P/Ligji "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane".

**-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)**

**-Komisioni i Punës dhe**

**Çështjeve Sociale**

**-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

**-Komisioni i Industrisë**

6. P/Vendim "Për shfuqizimin e tarifave të telefonisë fikse dhe të çmimeve të energjisë elektrike".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Industrisë**

**-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

7. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993 "Për statusin e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë nga sistemi komunist", ndryshuar me ligjin nr. 7771, datë 7.12.1993".

**-Komisioni i Ligjeve**

**-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

**-Komisioni i të Drejtave të Njeriut**

*E Enjte, datë 15.04.2004, ora 10.00*

**-Seancë Plenare -**

1. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1993 "Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. P/Ligji "Për shërbimin publik funeral".
3. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8366,

datë 2.7.1998 "Për shërbimin gjeologjik shqiptar (SH.GJ.SH.).

4. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992 "Për Festat Zyrtare e Ditëve Përkujtimore", i ndryshuar.
5. P/Vendim "Për caktimin e pagës së anëtarëve dhe Kryetarit të Bordit të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE).
6. P/Vendim "Për caktimin e pagës së anëtarëve dhe Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës".
7. Shqyrtimi i kërkesës së 5 deputetëve për ngritjen e Komisionit Hetimor për shpërdorimet dhe dëmet e shkaktuara në Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare.

*E Premte, datë 16.04.2004, ora 10.00*

Punë në komisione:

- Diskutimi dhe shqyrtimi i konkluzioneve të Raportit të Komisionit Europian të vitit 2004 mbi procesin e Stabilizim Asocimit.

**-Të gjitha komisionet**

*E Hënë, datë 19.04.2004, ora 18.00*

**-Seancë Plenare -**

1. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Egerem Spahia nga Kryeministri.
2. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Pëllumb Berisha, nga Ministri i Mjedisit.
3. Interpelancë me Ministrin e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, kërkuar nga deputeti Spartak Braho.
4. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Nikollë Lesi nga Ministri i Jashtëm.
5. Raport i Qeverisë për Shërbimin Civil 2003.

-Pyetje.

-Diskutime.

*E Martë, datë 20.04.2004*

*E Mërkurë, datë 21.04.2004*

*(Vijon në faqen 7)*



# Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

(Vijon nga faqja 6)

- Komisioni i Ligjeve**
- 1. P/Ligji "Për industrinë joushqimore".
  - Komisioni i Ligjeve**
  - Komisioni i Industrisë**
  - Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**
- 2. P/Ligji "Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës".
  - Rakordimi i vërejtjeve nga 3 komisionet**
- 3. P/Ligji "Për kriteret dhe kushtet që do të ndiqen për organizimin e ndarjes Administrativo-Territoriale të Republikës së Shqipërisë".
  - Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)**
  - Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**
- 4. P/Ligji "Për miratimin e Kodit Detar Shqiptar".
  - Komisioni i Ligjeve**
  - Komisioni i Mbrojtjes**
  - Komisioni i Industrisë dhe Telekomunikacionit**
- 5. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" (paraqitur nga një grup deputetësh).
  - Komisioni i Ligjeve**
  - Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**
- 6. P/Ligji "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".
  - Komisioni i Ligjeve**
  - Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit**
- 7. P/Ligji "Për shërbimin meteorologjik ushtarak".
  - Komisioni i Ligjeve**
  - Komisioni i Mbrojtjes**
- 8. P/Ligji "Për punën e Kuvendit në procesin e integritetit të

Shqipërisë në Bashkimin European".

- Komisioni i Ligjeve**
  - Komisioni i Jashtëm**
  - Komisioni i Rendit**
  - Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**
  - Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit**
  - Komisionet e tjera**
- E Enjte, datë 22.04.2004, ora 10.00**

- Seancë Plenare**
- 1. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe udhëtarëve".
- 2. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin "Infrastrukturës Ujore, Bashkiake".
- 3. P/Ligji "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9118, datë 24.7.2003 "Për faljen e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore të papaguara".
- 4. P/Ligji "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
- 5. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8950, datë 10.10.2002 "Për Gjendjen Civile".
- 6. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993 "Për statusin e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë nga sistemi komunist", ndryshuar me ligjin nr. 7771, datë 7.12.1993".
- 7. P/Vendim "Për shfuqizimin e tarifave të telefonisë fikse dhe të çmimeve të energjisë elektrike".

## Njoftim

**Të nderuar zonja e zotërinj,**  
Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare". Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.  
Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar të krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.  
Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.  
Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare "QSP" në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;  
"Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat. Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30  
Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP."

### Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator  
Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies  
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15  
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; [cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);  
[www.ascpdp.org](http://www.ascpdp.org)